



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 4578/prot.

Tiranë, më 24. 10. 2019

VENDIM

Nr. 47, datë 24. 10. 2019

Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20%, të planit mësimor të ciklit të parë, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, të UT-së, për vitin akademik 2019-2020

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, gërma “b”; neni 35, pika 9; neni 38, pika 1, gërma “dh”; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërma g; si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë me shkresë Nr. 929 Prot., datë 11.10.2019, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 24. 10. 2019;

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë për ndryshime, deri në masën 20%, në planin mësimor të programit të ciklit të parë të studimit, “Bachelor” në “Histori” që ofrohet nga ky fakultet, për vitin akademik 2019-2020
2. Ky vendim i përcillet për njoftim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI
PROF. DR. MYNYR KONI

